



SPECIALIST PROSECUTOR'S OFFICE
ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR
SPECIJALIZOVANO TUŽILAŠTVO

Nr: KSC-CC-2019-07

Vendos: **Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese**
Gjykatës Vidar Stensland, Kryetar i panelit
Gjykatës Roland Dekers
Gjykatës Antonio Balsamo

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Pjesëmarrës parashtrues: Prokurori i Specializuar

Data: 17 dhjetor 2019

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Përgjigja e Prokurorisë ndaj parashtrimt të protokolluar KSC-CC-2019-07/F00009

Zyra e Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësi i Specializuar për z.

Driton Lajçi

Z. Tobi Kadman

1. Në bazë të autorizimit të lëshuar nga paneli,¹ Zyra e Prokurorit të Specializuar ('ZPS') i përgjigjet kundërpërgjigjes² së z. Driton Lajçi ('Parashtruesit'). Kundërpërgjigja demonstroi më tej papranueshmërinë dhe mungesën e themelësisë së kërkesës referuese.³
2. Së pari, kompetencat e gjykatësit të procedurës paraprake apo të gjykatësit të vetëm, përcaktuar në nenin 39 të Ligjit⁴ dhe në rregullën 48(2) të Rregullores⁵ së DHSK-së, nuk kufizohen vetëm në shqyrtimin e ligjshmërisë së një fletëthirrjeje.⁶ Përkundrazi, ato përfshijnë shprehimisht, *inter alia*, 'urdhra që mund të jenë të nevojshëm për ta ndihmuar atë person të përgatisë mbrojtjen e tij'.⁷ Kjo qartësisht përfshin çështje që lidhen me njoftimin dhe/ose dhënien e informacionit. Parashtruesi lirisht mund të kërkonte një vendim në lidhje me këtë në çfarëdo kohe.⁸ Pretendimi i pabazuar i parashtruesit se gjykatësi i procedurës paraprake ose gjykatësi i vetëm nuk ka kompetenca për të marrë vendim në lidhje me shkelje të pretenduara të të drejtave⁹ është në kundërshtim me dispozitat e shprehura të kornizës së zbatueshme ligjore dhe

¹ Njoftim në lidhje me parashtrimin e kundërpërgjigjes, KSC-CC-2019-07/F00011, 11 dhjetor 2019. Për caktimin e panelit për shqyrtimin e çështjes ('paneli') *shih* Vendim për caktimin e gjykatësve në një panel të Gjykatës Kushtetuese, KSC-CC-2019-07/F00002, 15 nëntor 2019.

² Kundërpërgjigje e Mbrojtjes ndaj përgjigjes së Prokurorisë ndaj kërkesës referuese të z. Driton Lajçi drejtuar Gjykatës Kushtetuese, KSC-CC-2019-07/F00009, 9 dhjetor 2019 ('kundërpërgjigja').

³ Kërkesë referuese drejtuar panelit të gjykatës kushtetuese në lidhje me ligjshmërinë e procedurës së marrjes në pyetje, KSC-CC-2019-07/F00001, 13 nëntor 2019, shpërndarë më 14 nëntor 2019 ('kërkesa referuese').

⁴ Ligji No.05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, 3 gusht 2015 ('Ligji').

⁵ Rregullore e Procedurës dhe e Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës, KSC-BD-03/Rev1/2017, 5 korrik 2017 ('Rregullorja e DHSK-së').

⁶ *Shih*. Kundërpërgjigja, KSC-CC-2019-07/F00009, para. 8.

⁷ Ligji, neni 39(10).

⁸ *Shih*. Kundërpërgjigja, KSC-CC-2019-07/F00009, para. 13-16. Përveç kësaj, argumentet e parashtruesit në lidhje me rregullën 20(1) të Rregullores së Punës së Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, KSC-BD-03/Rev1/2017, 21 korrik 2017 ('Rregullorja e Punës') (Kundërpërgjigja, KSC-CC-2019-07/F00009, para. 17-21) i shmangen dhënies së përgjigjes, sepse përqendrohen në llogaritjen e dy muajve dhe jo në faktin që nuk ekziston një vendim përfundimtar prej të cilit të fillohet llogaritja e periudhës dymujore.

⁹ Kundërpërgjigja, KSC-CC-2019-07/F00009, para. 9-12.

jurisprudencën përkatëse.¹⁰ Parashtruesi nuk i ka shfrytëzuar të gjitha mjetet juridike të disponueshme dhe kërkesa referuese duhet të hidhet poshtë.¹¹

3. Së dyti, tani duket sikur parashtruesi lë të kuptohet që neni 6(3) i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut ('KEDNj') nuk përbën bazën ligjore parësore të pretendimit të tij.¹² Ndonëse vazhdon të pohojë se po i shkelen të drejtat,¹³ parashtruesi përsëri nuk i ka identifikuar askund – as në kërkesën referuese e as në kundërpërgjigje – dispozitat kushtetuese konkrete që pretendon se janë shkelur. Siç është shprehur edhe më parë ZPS-ja,¹⁴ qoftë edhe vetëm kjo mungesë qartësie përbën në vetvete një arsye të mëtëjshme për refuzimin e kërkesës referuese.

4. Gjithashtu, vetë parashtruesi tani pranon që (i) para dhe pas nxjerrjes së aktakuzës zbatohen detyrime të ndryshme;¹⁵ (ii) në fazën e intervistës nuk është e

¹⁰ Shih Përgjigje e Prokurorisë ndaj kërkesës referuese të z. Driton Lajçi drejtuar panelit të Gjykatës Kushtetuese mbi ligjshmërinë e procedurës së marrjes në pyetje, KSC-CC-2019-07/F00008, 2 dhjetor 2019 ('Përgjigja e ZPS-së'), para. 10.

¹¹ Përgjigja e ZPS-së, KSC-CC-2019-07/F00008, para. 10-15.

¹² Kundërpërgjigja, KSC-CC-2019-07/F00009, para. 38-39 (që duket se kundërshton faktin që parashtrimet e ZPS-së përqendroheshin në atë dispozitë).

¹³ Kundërpërgjigja, KSC-CC-2019-07/F00009, para. 12.

¹⁴ Përgjigja e ZPS-së, KSC-CC-2019-07/F00008, para. 16. *Shih edhe* GJKK, Lënda nr. KI 58/17, *Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Pml. nr. 326/2016 të 23 janarit 2017*, 4 dhjetor 2017, para. 64 ('parashtruesi i kërkesës duhet ta deklarojë shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese dhe të tregojë se cilat nene të Kushtetutës janë shkelur; të përshkruajë rrethanat e shkeljes lidhur me aktin ose vendimin e kontestuar; të specifikojë si dhe pse ishin shkelur; të paraqesë dëshmi relevante dhe përkatëse se si dhe pse është kryer shkelja; të përcaktojë natyrën e shkeljes dhe të shpjegojë implikimet kushtetuese të shkeljes; të dëshmojë me argumente të vlefshme dhe bindëse se veprimet e autoritetit publik janë në kundërshtim me normat kushtetuese'); GJKK, Lënda nr. KI 78/13, GJKK, Lënda nr. KI 78/13, *Roland Bartetzko, Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Panelit për Lirim me Kusht MD/CRP-No.474/12 i datës 29 dhjetor 2012 dhe Udhëzimit Administrativ 2009/1 të Ministrisë së Drejtësisë*, 2 maj 2014, para. 25, 30 (si përmbledhje, parashtruesi nuk ka treguar pse dhe si janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë. Deklarata e thjeshtë se është shkelur Kushtetuta nuk mund të konsiderohet ankesë kushtetuese'; duke e shpallur kërkesën qartazi të pabazuar dhe, rrjedhimisht të papranueshme); GJKK, Lënda nr. KI 154/15, *Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës PML. nr. 67/2015 të 9 korrikut 2015*, 29 nëntor 2016, para. 46 ('Gjykata vëren se parashtrueset e kërkesës nuk kanë ngritur para saj një pretendim të saktë dhe konkret për shkeljen e të drejtave të tyre dhe nuk kanë shpjeguar se si dhe pse Aktgjykimi i Gjykatës Supreme mund t'i ketë shkelur të drejtat e tyre kushtetuese; ato vetëm kanë përmendur se ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese. [...]').

¹⁵ Kundërpërgjigja, KSC-CC-2019-07/F00009, para. 29, 43. Në lidhje me pretendimin e parashtruesit se ZPS-ja me qëllim i ka shtrembëruar parashtrimet e tij të mëparshme në lidhje me këtë pikë (Kundërpërgjigja, KSC-CC-2019-07/F00009, para. 25), ZPS-ja i referohet, *inter alia*, paragrafëve 3.7 dhe 4.2 të kërkesës referuese (ku parashtrohet propozimi që të drejtat e nenit 21(4) 'të përfshihen' ose 'të bëjnë pjesë' në nenin 38).

nevojshme të bëhen të ditura të dhënat e dëshmitarëve të veçantë, provat që mund të dëmtojnë hetimin, apo tërësia e argumenteve dhe provave të prokurorisë;¹⁶ dhe (iii) masa e vënies në dijeni në fazën e intervistës i lihet gjyqimit të zyrtarit që kryen intervistën.¹⁷

5. Parashtruesi po hetohet për vepra penale të pretenduara kundër administrimit të drejtësisë; është e vetëkuptueshme që në këtë fazë nuk mund të jepen të dhëna specifike të këtyre pretendimeve pa komprometuar dëshmitarët dhe provat e mundshme. Gjithashtu, siç është parashtruar edhe më herët nga ZPS-ja,¹⁸ kjo vënie në dijeni jo vetëm që nuk është e nevojshme për përmbushjen e qëllimeve të nenit 6 të KEDNJ-së, por edhe një specifikim tejet i hollësishëm i natyrës dhe shkakut të akuzave në fazën hetimore të zbulimit të fakteve në të vërtetë mund t'i komprometonte ato të drejta nëse i dyshuari do të nxirrte përfundimin e gabuar se mund të bëhet fjalë vetëm për akuzat e përvijuara dhe, mbi atë bazë, të vendoste të hiqte dorë nga disa të drejta të caktuara.¹⁹

6. Së fundi, edhe baza faktike e kërkesës referuese duket se është riformuluar dhe orientuar drejt pretendimit që ZPS-ja zbaton 'një qasje gjithëpërfshirëse sipas së cilës nuk jepet asnjë informacion në asnjë kohë'.²⁰ Ky pretendim (i) është i pabazuar dhe i pavërtetë nga ana faktike,²¹ dhe (ii) hidhet poshtë nga vetë dokumentacioni i kësaj

¹⁶ Kundërpërgjigjja, KSC-CC-2019-07/F00009, para. 31-32, 43.

¹⁷ Kundërpërgjigjja, KSC-CC-2019-07/F00009, para. 45.

¹⁸ Përgjigjja e ZPS-së, KSC-CC-2019-07/F00008, para. 20-25.

¹⁹ *Shih po ashtu* Përgjigjja e ZPS-së, KSC-CC-2019-07/F00008, para. 25 (ku përvijohet më tej se pse do të ishte e pazbatueshme dhe e pamatur që të shpërfillej dallimi midis fazës hetimore të zbulimit të fakteve dhe pikënisjes së gjyqimit).

²⁰ Kundërpërgjigjja, KSC-CC-2019-07/F00009, para. 9, 29-30, 36, 39 ('për hir të qartësisë, sikurse është argumentuar në parashtrimet fillestare të parashtruesit, argumenti ynë është se, qëndrimi sipas të cilit të dyshuarit nuk i jepet asnjë informacion përpara intervistës [...]), 45-46. *Krahaso* argumentet e parashtruara në kërkesën referuese, KSC-CC-2019-07/F00001, para. 1.2-1.3.

²¹ Çka ZPS-ja tha në fakt është se 'Ligji nuk parashtron se ZPS-ja duhet t'i japë klientit tuaj hollësi të provave që posedon në këtë fazë' (Përgjigjja e ZPS-së, Shtojca 2, KSC-CC-2019-07/F00008/A02). Ky pohim – që duket se përbën bazën parësore faktike të ankesës së parashtruesit (*shih* Kundërpërgjigjja, KSC-CC-2019-07/F00009, para. 9 (që i referohet shkëmbimeve me postë elektronike)) – qartësisht kufizohet në hollësitë e provave bazë dhe, as në këtë rast, nuk ofron arsye për të nxjerrë përfundimin se qasja është gjithëpërfshirëse.

çështjeje.²² Vlen të theksohet se në kundërpërgjigje parashtruesi nuk e kundërshton që nuk është paragjykuar aspak;²³ kur nuk iu dha informacion i mëtejshëm gjatë intervistës, ai vendosi të ushtronte të drejtën e tij për të mbajtur heshtje dhe rrjedhimisht, në bazë të Ligjit, ai nuk do të ketë asnjë pasojë nga marrja apo mosmarrja në pyetje.²⁴ Çka mbetet është thjesht një kundërshtim abstrakt²⁵ të cilin parashtruesi nuk është i autorizuar ta paraqesë²⁶ dhe të cilin, rrjedhimisht, paneli duhet ta refuzojë.

Numri i fjalëve në origjinal: 1,707

/nënshkrimi/

Xhek Smith

²² *Shih* Përgjigjja e ZPS-së, KSC-CC-2019-07/F00008, para. 27-29. *Contra. inter alia* Kundërpërgjigjja, KSC-CC-2019-07/F00009, para. 33.

²³ Përgjigjja e ZPS-së, KSC-CC-2019-07/F00008, para. 30-31.

²⁴ Ligji, neni 38(3). Paragjykimi do të ekzistonte vetëm nëse parashtruesi do të pretendonte se ka 'të drejtën' për t'u marrë në pyetje si i dyshuar dhe të jepte informacionet e tij në fazën hetimore para ngritjes së akuzës. Parashtruesi as nuk e ka paraqitur dhe as nuk mund ta paraqiste këtë argument. Kjo nuk parashihet as në Ligj dhe as në ndonjë instrument tjetër ligjor të zbatueshëm.

²⁵ Kundërpërgjigjja, KSC-CC-2019-07/F00009, para. 9 (ku përmendet se kundërshtimi ka të bëjë me rregullat dhe nëse korniza ligjore është e ligjshme), 12 (ku përmendet 'ligjshmëria dhe/ose kushtetutshmëria' e pozicionit të pretenduar të ZPS-së), 29-30, 36, 39, 45-46. *Shih edhe* Përgjigjja e ZPS-së, KSC-CC-2019-07/F00008, para. 16 (ku përmenden parashtrime të mëhershme të cilat po ashtu nuk kanë lidhje me Kushtetutën dhe/ose janë të parakohshme dhe abstrakte).

²⁶ *Shih, për shembull*, GJKK, Lënda nr. KI 102/17, *Vlerësim i kushtetutshmërisë së Udhëzimit Administrativ nr. 09/2015 për kategorizimin e shfrytëzuesve të pensionit kontributpagues sipas strukturës kualifikuese dhe kohëzgjatjes së pagesës së kontributeve-stazhit pensional të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale*, 13 shkurt 2018, para. 19 ([Gjykata rithekson se teksti kushtetues dhe jurisprudenca e kësaj Gjykate nuk ua njohin të drejtën individëve që të kontestojnë *in abstracto* akte të karakterit të përgjithshëm.) dhe 20 ([Gjykata rithekson se teksti kushtetues dhe jurisprudenca e kësaj Gjykate nuk ua njohin të drejtën individëve që të kontestojnë *in abstracto* akte të karakterit të përgjithshëm.); GJKK, Lënda nr. KI 78/13, *Roland Bartetzko, Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Panelit për Lirim me Kusht MD/CRP-No.474/12 i datës 29 dhjetor 2012 dhe Udhëzimit Administrativ 2009/1 të Ministrisë së Drejtësisë*, 2 maj 2014, para. 26-29. *Shih po ashtu*, Gjykata Evropiane e Të Drejtave të Njeriut ('GJEDNJ'), *Burden v. The UK*, nr. 13378/05, 29 prill 2008, para. 33; GJEDNJ, *SL v. Austria*, nr. 45330/99, 22 nëntor 2001, p.6; Gjykata Penale Ndërkombëtare, *Dhoma e Apelit, Prosecutor v. Lubanga*, ICC-01/04-01/06 OA 15 OA 16, 'Judgement on the appeals of Mr. Lubanga Dyilo and the Prosecutor against the Decision of Trial Chamber I, i 14 korrikut 2009 me titull "Decision giving notice to the parties and participants that the legal characterisation of the facts may be subject to change in accordance with Regulation 55(2) of the Regulations of the Court"', 8 dhjetor 2009, para. 110, ('[n]ë mënyrë të ngjashme, për sa i përket argumenteve të z. Lubanga Dyilo në lidhje me shkëljen e pretenduar të të drejtave të tij themelore, çdo diskutim nga Dhoma e Apelit i çështjeve të ngritura do të ishte abstrakt dhe hamendësues').

Prokurori i Specializuar

E martë, 17 dhjetor 2019

Hagë, Holandë